

V E N D I M
Nr.599, datë 20.12.1994

**PËR FUSHAT DHE PROJEKTET PËRPARËSORE PËR T'U FINANCUAR NGA FONDET
IDA TË BANKËS BOTËRORE NË VITET 1995-1997**

Me propozimin e Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe të Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Strategjia e ardhshme e bashkëpunimit me Bankën Botërore të mbështetet në përqendrimin e kërkesave për financime në më pak projekte, por me kosto totale dhe me impakte më të larta zhvillimi.

2. Të miratojë në parim vazhdimin e procedurave për vitin fiskal 1995 për projektet përparësore të mëposhtme:

1. Projekti i modernizimit të administratës së taksave.
2. Ripërtëritja e sektorit financiar dhe atij të ndërmarrjeve.
3. Projekti i ujitjes.
4. Rehabilitimi i shërbimeve shëndetësore.
5. Projekti i humbjeve të energjisë.
6. Projekti i zhvillimit rural.

Përveç këtyre projekteve, brenda vitit fiskal 1995, të vazhdohet faza programuese për projektin e rrugëve ushqyese.

3. Të miratojë në parim, për vitet fiskal 1996 dhe 1997 fushat e mëposhtme përparësore të bashkëpunimit me Bankën Botërore:

Për vitin 1996:

- Energjia
- Transporti
- Pyjet

Për vitin 1997:

- Banesat
- Furnizimi me ujë
- Përpunimi i produkteve bujqësore

4. Ministrinë dhe institucionet e tjera përkatëse të ndjekin zbatimin e detyrave të përcaktuara në aneksin që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi